

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Keshilli i Ministrave

U D H E Z I M

Nr. 3 Date 19.2.1996

PER

BLERJET ME VLERA TE VOGLA

Me propozim te Agjencise se Prokurimit Publik, Keshilli i Ministrave

U D H E Z O N :

1. Komisioni per prokurimin e blerjeve te vogla perbehet nga jo me pak se kater anetare dhe caktohet cdo vit kalendarik nga titullari i entit prokurues, sipas formularit nr.1 bashkelidhur ketij udhezimi.

Kryetari i komisionit eshte shefi i finances i entit prokurues.

Kur enti prokurues ka njesi prokurimi te krijuar, qe funksionin sipas Udhezimit te Keshillit te Ministrave nr.1 date 1.1.1996 me jo me pak se dy specialiste prokurimi dhe nje jurist, keta do te jene edhe anetaret e komisionit te prokurimit.

Nese enti prokurues nuk ka njesi prokurimi te krijuar, atehere do te caktoje nje komision prej jo me pak se tre anetaresh, pervec kryetarit sipas paragrafit te dyte.

2. Ne blerjet me vlere te vogel, pervec mallrave, hyjne edhe te gjitha sherbimet me vlere te vogla si p.sh. larje filmash e stampim fotografish, fotokopime, riprodhim celesash, riparim ose nderrim bravash, riparime te pajisjeve te ndryshme si makina shkrimi, fotokopjatrice, kompjuter etj, zhbllokim i shkarkimeve te ujrave, riparime te vogla te difekteve te automjeteve gjate udhetimeve dhe sherbime te tjera te kesaj natyre.

3. Nevojat per blerjet me vlere te vogla qe do te kryhen me proceduren e prokurimit te drejtperdrejte, sipas nenit 19, pika 2 te ligjit 7971 date 26.7.1995, "Per prokurimin publik", percaktohen nga kryetari i entit prokurues ne urdherin e prokurimit, sipas formularit nr.2 qe i bashkengjitet ketij udhezimi, duke percaktuar llojin e mallrave ose sherbimeve dhe sasine per cdo mall ose sherbim.

Ne institucionet qendrore, nese tiullari i institucionit e sheh te arsyeshme, formulari nr.2 mund te firmoset nga nje person tjeter i autorizuar prej titullarit, qe mund te jete shefi i kabinetit, drejtori i personelit ose shefi i administrates.

4. Komisioni, mbasi merr urdhrin e prokurimit, cakton dy anetare qe do te kryejne blerjen te cilet shkojne ne njesite e shitjes me listen e dhene ne urdherin e prokurimit dhe marrin cmimet per cdo mall ose sherbim. Keto cmime ia propozojne komisionit. Mbasi gjithe komisioni bie dakord me cmimet e propozuara, behet procesverbali, sipas formularit nr.3 qe i bashkelidhet ketij udhezimi, ku percaktohen anetaret qe ngarkohen per kryerjen e blerjeve, si dhe cmimet e miratuara per cdo blerje. Procesverbali firmoset nga te gjithe anetaret e komisionit.

Anetaret e ngarkuar nga komisioni kryejne blerjet me cmimet e miratuara ne procesverbalin e siperpermendur dhe sjellin faturat perkatese te firmosura dhe vulosura nga njesia e shitjes. Faturat firmosen edhe nga anetaret qe kane kryer blerjen dhe i bashkelidhen urdhrin te prokurimit dhe procesverbalit, per t'u dorezuar ne llogari.

5. Blerjet me vlere deri ne 10 mije leke mund te kryhen me leke ne dore, ndersa blerjet me vlere me te madhe se 10 mije leke duhet te kryhen me urdherxhirimi.

6. Ne rastet e emergjences, kur nuk mund te leshohet paraprakisht nje urdher prokurimi dhe kur komisioni nuk mund te mblidhet per te miratuar cmimin, sepse nevoja per sherbimin del e papritur dhe nuk mund te parashikohej (p.sh. plasja e gomes se makines gjate udhetimit apo difekte te tjera qe duhen riparuar ne vend dhe me urgjence, zhbllokimi i tubacioneve te shkarkimit ose raste te tjera te ngjashme), fatura do te pranohet me firmen e shitesit ose specialistit qe kryhen sherbimin dhe vulen e njesise se shitjes ose servisit perkates, e firmosur nga personi qe ka kryer pagesen (qe nuk eshte e nevojshme te jete anetar komisioni).

Ne keto raste komisioni mbas paraqitjes se fatures nga personi i interesuar mblidhet dhe me nje procesverbal, sipas formularit nr.4 qe i bashkengjitet ketij udhezimi, miraton shpenzimin e bere dhe justifikon rastin e emergjences per blerjen ne fjale, si dhe pamundesine e parashikimit te saj. Procesverbali firmoset nga gjithe anetaret e komisionit dhe miratohet perfundimisht nga titullari i entit prokurues. Ky procesverbal do te jete ekuivalent me urdhrin e prokurimit (formulari nr.2) dhe procesverbalin (formulari nr.3), qe perpilohen per rastin e blerjeve te parashikuara, dhe i bashkengjitur me faturen perkatese, dorezohet ne llogari.

Ky udhezim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE

ALEKSANDER MEKSI

Formulari Nr.1

(enti prokurues)

URDHER

Nr..... date.....

PER KRIJIMIN E KOMISIONIT TE PROKURIMIT

PER BLERJET ME VLERA TE VOGLA

Te krijohet komisioni i prokurimit per blerjet me vlere te vogla i perbere nga:

1. _____ Kryetar
2. _____ Anetar
3. _____ Anetar
4. _____ Anetar

Ky komision do te funksionoje gjate gjithe vitit kalendarik _____.

KRYETARI I ENTIT PROKURUES

(emri, mbiemri, firma, vula)

Formulari Nr.2

(enti prokurues)

URDHER PROKURIMI

Nr..... date.....

PER BLERJET ME VLERA TE VOGLA

Mbeshtetur ne nenin 19, pika 2, te ligjit nr.7971 date 26.7.1995 "Per prokurimin publik", per nevoja te _____, te perdoret (enti prokurues) procedura e prokurimit te drejtperdrejte per blerjet e meposhtme:

1. _____ (malli ose sherbimi) _____ (sasia dhe njesia)
2. _____ (malli ose sherbimi) _____ (sasia dhe njesia)
3. _____ (malli ose sherbimi) _____ (sasia dhe njesia)
- Etj. _____ (malli ose sherbimi) _____ (sasia dhe njesia)

KRYETARI I ENTIT PROKURUES
OSE PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ

(emri, mbiemri, firma, vula)

Formulari Nr.3

PROCESVERBAL

I mbajtur sot me date _____ ne _____
(data) (enti prokurues)
nga komisioni i prokurimit per blerjet me vlera te vogla, i krijuar me urdherin e brendshem nr. _____ dt. _____, ne zbatim te
(numri i urdhrit) (data e urdhrit)

urdhrit te prokurimit nr. _____ dt. _____ per aprovimin e cmimit
(numri i urdhrit) (data e urdhrit)

te blerjeve si me poshte:

1. _____
(malli ose sherbimi) (sasia dhe njesia) (çmimi) (vlera)

2. _____
(malli ose sherbimi) (sasia dhe njesia) (çmimi) (vlera)

3. _____
(malli ose sherbimi) (sasia dhe njesia) (çmimi) (vlera)

Etj. _____
(malli ose sherbimi) (sasia dhe njesia) (çmimi) (vlera)

Ngarkohen anetaret e komisionit:

1. _____
(emri, mbiemri)

2. _____
(emri, mbiemri)

per kryerjen e blerjeve te sipershenuara me cmimet e miratuara ne kete procesverbal .

KOMISIONI

1. _____
(emri, mbiemri, firma)

2. _____
(emri, mbiemri, firma)

3. _____
(emri, mbiemri, firma)

KRYETARI I KOMISIONIT

(emri, mbiemri, firma)

Formulari Nr.4

PROCESVERBAL

I mbajtur sot me date _____ ne _____
(data) (enti prokurues)

nga komisioni i prokurimit per blerjet me vlere te vogla, i krijuar me

urdherin e brendshem nr. _____ dt. _____, per aprovimin e
(numri i urdhrit) (data e urdhrit)

cmimit te paguar nga _____ per
(emri i personit qe ka kryer pagesen)

_____ me faturen nr. _____
(malli ose sherbimi) (numri i fatures)

dt. _____, leshuar nga _____ .
(data e fatures) (njesia e shitjes ose servisit)

Nevoja per _____ ndodhi me date _____
(mallin ose sherbimin) (data)

ne _____
(data e ngjarjes) (vendi dhe rrethanat e ngjarjes)

Kjo ngjarje nuk mund te parashikohej dhe urgjenca e _____
(mallit ose sherbimit)
nuk lejonte mbledhjen e komisionit te blerjeve me vlera te vogla per te
miratuar paraprakisht cmimin e fatures.

KOMISIONI

1. _____
(emri, mbiemri, firma)
2. _____
(emri, mbiemri, firma)
3. _____
(emri, mbiemri, firma)

KRYETARI I KOMISIONIT

KRYETARI I ENTIT PROKURUES

(emri, mbiemri, firma)

(emri, mbiemri, firma, vula)